

LIGJ
Nr. 111/2020

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8743, DATË 22.2.2001, “PËR PRONAT E
PALUAJTSHME TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 41, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) “bregu i detit” është sipërfaqja e tokës përgjatë detit, me gjerësi dhe kufi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, e cila është pronë publike e patjetërsueshme.”.

Neni 2

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 3 pas fjalëve “vija bregdetare për të hyrë në tokë” shtohen fjalët “bregu i detit”.

Neni 3

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

**Pronat e shtetit në përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore, që u kalojnë
me destinacion palëve të treta**

Pronat e paluajtshme të shtetit, të cilat u kanë kaluar në përgjegjësi administrimi institucioneve qendrore, sipas dispozitave të këtij ligji, për t’u vendosur në dispozicion të subjekteve të së drejtës private, që synojnë realizimin e një interesi publik pa qëllim fitimi, të themeluara dhe që funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, përdoren për aq kohë sa subjekti privat jofitimprurës ekziston, destinacioni i përdorimit dhe zhvillimit të pronës nuk ndryshon dhe kur në pronë është kryer investim mbi 5 milionë euro për qëllimet e aktivitetit të tij.

Rregullat dhe procedurat për lidhjen e kontratës së përdorimit pa afat, sipas kritereve të mësipërme, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në çdo rast, në kontratën e përdorimit do të specifikohet se pronës nuk mund t’i ndryshohet destinacioni.

Në asnjë rast kjo pronë, së bashku me ndërtimet, investimet dhe përmirësimet e saj, nuk mund të jetë objekt i asnjë barre hipotekore apo procedure ligjore nga kreditorët e subjektit

juridik privat jofitimprurës, për të realizuar vjeljen e detyrimeve që këta kreditorë kanë ndaj personit juridik privat jofitimprurës.”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.